

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Përndjekja si “meritë” politike e Flamingove
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/26/perndjekja-si-merite-politike-e-flamingove/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 15:17:58 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 15:16:12 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	eb13b04cc2c4a01fecfba89e268c18b1a3ff25e133687eafef38e357c2150f9d
TEKSTI	efd4bc50aca1ed62e9535a7b96b3d76bc5aa90662eaff451414046dd8335dd4b
PAMJA	dce1335a701774eda493a9db62aec465be2762794822587f315d86db98447fd1

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5b4a8e4ee24933f43c26e58fef9771f2bb448166b4485719d506d16953dcba8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c646a932fde53c288233dea515333d4375993381cb212e1a0a5e6c9db33460b4
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5b4a8e4ee24933f43c26e58fef9771f2bb448166b4485719d506d16953dcba8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Përndjekja si “meritë” politike e Flamingove

Analizë

Publikuar: 26/09/2026

f X

**N**ga Bjorn Runa

Një grup përfaqësues i protestuesve ‘Flamingo,’ prej disa javësh tashmë filmon dhe shpërndan në rrjete sociale video se si përndjek politikanë të ndryshëm, duke e paraqitur këtë si arritje politike të protestës. Rasti më i fundit ishte ai i deputetit Bledi Çuçi, i cili u rrethua prej tyre gjatë një darke familjare, por skena të ngjashme i kemi parë të përsëriten edhe me deputetë e politikanë të tjerë.

Nuk ka kurrfarë arsyeje për të qenë protektiv ndaj klasës sonë politike. Përkundrazi, ajo duhet të përballet me kritika dhe një opozitë fortë publike e, madje në raste të caktuara, protestat duhet t’ia ndërpresin rutinën e përditshme politike. Por, përshkallëzimi ka nevojë për një synim që shkon përtej dëshirës që kanë katër apo pesë veta për të treguar se mund t’i prishin pasditen një politikan të caktuar.

Mirëpo, pyet se çfarë synojnë të arrijnë përballje të tilla veç videove denigruese dhe përgjigjia që do të marrësh është se kjo nuk është dhunë dhe se duhet të shqetësohesh më tepër për korrupsionin dhe problemet e vendit se sa për akte të tilla. Logjika e Flamingove se, nëse nuk jua duartroket çdo budallallëk që bëjnë atëherë je në anën e qeverisë, është e njëjtë me atë të politikanëve kundër të cilëve thonë se po luftojnë, sipas të cilëve kushdo që ju vë në dyshim metodat, është automatikisht në anën e “armikut.”

Më e keqja është se e gjithë kjo uri për të përndjekur njerëz, po shtrihet tanimë përtej politikanëve, tek qytetarët e zakonshëm që nuk pranojnë të përfshihen në rezistencën e Flamingove sipas kushteve të tyre.

Incidenti i djeshëm gjatë një takimi të deputetit socialist Erion Braca me banorë të zonës që ai përfaqëson, e tregon qartë këtë

Me të lexuarat



Ish-shefja e SHISH/ Nuk shantazhoi median, por kërcënoi armiq të e saj



Historia e dyshtim të ankandit të Llatjas, si u bë Kujtim Llupa pronar i Klubit



Vlorë/ Ardi Kollçaku, marrëveshje me “grupin e kokainës” për “Kullën e



Drone euro tendera / Kush është fierakja Diana Laba që vjedh paratë e bashkive me



Rusja po përgatit sulme me dronë ndaj Italisë, Spanjës dhe Francës

bruçe me banorë të zones që ai përfaqëson, e tregon qartë kete. Teksa bisedonte me banorët, i njëjti grup i 'Flamingove OJF' tentoi ta pengonte takimin dhe kur qytetarët kërkuan prej tyre që të lejoheshin të flisnin, u përballën me britma dhe akuza se duhej t'iu vinte turp që kishin zgjedhur t'i ankoheshin një përfaqësuesi të mazhorancës për problemet e tyre, në vend që të protestonin bashkë me ta.

Ajo që aktivistët duket se harrojnë është se, për shumicën e njerëzve, protesta është një mjet për të zgjidhur probleme konkrete dhe për këtë mund të tubohen, të marshojnë, apo të ankohen tek deputetët, pa qenë të detyruar të pyesin 'Flamingot OJF' se cila është mënyra e duhur, sikur të ishin pronarë ekskluzivë të halleve të njerëzve.

Duke e ndërprerë atë takim me thirrje 't'iu vijë turp,' drejtuar qytetarëve që kërkuan që të vazhdonte, aktivistët treguan praktikisht se sa të pasinqertë janë kur thonë se flasin në emër të qytetarëve sepse nëse do ta kishin seriozisht, atëherë do t'i kishin dëgjuar po me aq seriozitet ankesat e tyre. Por, ja që qytetarët në atë moment ishin pengesë ndaj nevojës së tyre për të filmuar performancën e radhës dhe shqetësimet e tyre mund të prisnin.

E gjitha është një taktikë e mjerë për të mbrojtur të papërfaqësuarit, por që tregon gjithashtu se e vetmja lloj pjesmarrije që 'Flamingot OJF' janë të gatshëm të tolerojnë është ajo ku njerëzit vijnë vetëm si trupa për të mbushur sheshin, që këta t'i fotografojnë e t'i paraqesin si dëshmi të suksesit të aktivizmit të tyre kur të aplikojnë për fondet e radhës. Por, në momentin që njerëzit tentojnë të flasin dhe të mendojnë vetë për veten e tyre, etiketohen si tradhëtarë sepse nuk thonë gjërat që duan ata të thonë.

Një lëvizje që nisi si protestë kundër privatizimit të pasurisë publike, do të duhej të ishte veçanërisht e vëmendshme ndaj përpjekjeve për privatizimin e zemërimit publik. Dhe para se të na i paraqesin këta katër-pesë flamingo të dhunshëm si shpresën e së ardhmes, admiruesit e tyre duhet të mendojnë një herë se çfarë na kanë treguar deri tani.

Tani që s'kanë as post e as pushtet, janë të gatshëm të vendosin se kush ka të drejtë të flasë dhe kush duhet denigruar publikisht, duke e shkatërruar kështu edhe vetë protestën. Vështirë të mendosh se si pushteti do t'ua korrigjonte këto zakone për të cilat po duartrokten ende pa e patur atë.

E vetmja "meritë" që ky grup na e ka dokumentuar me zell është aftësia për të përndjekur njerëz. Për t'ua njohur këtë, na mjaftojnë videot. Për t'i shpallur shpresë për të ardhmen, na duhet së pari të harrojmë ç'kemi parë në to.



Në kohën e Super Inteligjencës,
merremi me Super Budallëqe!

Këshilli i Sigurisë së Kombit që
mblidhet për “radarin” e Gysit

Vlora Hyseni na tha të gjithëve:
“Nuk kam ndër mend ta dorëzoj
kokën në sini të ergjëndtë”

Prapaskena

‘Prapaskena’ lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. ‘Prapaskena’ është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.’

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

Kategoritë

[KREU](#) [INVESTIGIM](#)

[KRIM & KORRUPSION](#) [DOSJE ROZË](#)

[KRYESORE](#) [POLITIKË](#) [EKONOMI](#)

[ANALIZË](#) [RAJON](#) [KULTURË](#) [SPORT](#)



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)